

Fjalim

Z. Ançe Trifunov
Sekretar Shtetëror
Ministria e Ekonomisë

**"KRIJIMI I TREGJEVE NGA REZULTATET
E KËRKIMEVE"**

Konferencë me rastin e shënimit të 20 vjetorit të themelimit të Entit
shtetëror të pronësisë industriale

Muzeu i luftës maqedonase

29 nëntor 2013
Shkup

Zonja dhe zotërinj,

Është nder dhe kënaqësi t'ju drejtohem me rastin e 20 vjetorit të themelimit të Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale dhe 20 vitet nga miratimi i Ligjit për Pronësi Industriale të Republikës soviane dhe të pavarur të Maqedonisë. Sidomos kënaqësi dhe nder të veçant më bëjnë që në këtë ditë festive për Republikën e Maqedonisë, këtu në Shkup, së bashku me ne erdhën të shënojmë këtë manifestim edhe institucionet e larta në të cilat Republika e Maqedonisë është shtet-anëtare si dhe drejtoret dhe përfaqësuesit e lartë të Enteve fqinje.

Më lejoni që të përshëndes z. Stiv Tom, Këshilltar në zyrën e z. Fransis Gari Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, z. Vim Van Der Eijk, zëvendës – president i z. Benoa Batisteli, president i Zyrës Evropiane të patentave, ju mysafirë të nderuar nga Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Serbia, Kroacia dhe Rumania. Më lejoni gjithashtu të uroj këtë përvjetor të vogël por jubile i rëndësishëm për drejtorin e Entit, z. Safet Emruli dhe bashkëpunëtorët e tij si dhe gjithë punonjësve në Entin Shtetëror të Pronësisë Industriale.

Zonja dhe zotërinj,

Shfrytëzojë rastin t'ju informojë për aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me të cilën një rëndësi të veçantë u jepet inovacioneve dhe pronës intelektuale si një element kyç për rritjen e aftësisë konkuruese të ekonomisë në vend si dhe rolit të Entit shtetëror për pronësi industriale për realizimin e tyre.

Aktivitetet në fushën e mbështetjes së inovacioneve, kryesisht kanë të bëjnë me krijimin e një kuadri ligjor për të inkurajuar dhe mbështetur kapacitetin inovativ të ekonomisë dhe ekonominë, në radhë të parë, por edhe duke siguruar mekanizma për mbështetje financiare për realizimin dhe zhvillimin e projekteve të reja edhe atë duke krijuar mundësi për bashkë - financimin, subvacioneve dhe kredive në sektorin inovativ në vend.

Në kohën e fundit institucionet e arsimt të lartë në Republikën e Maqedonisë, si dhe në pjesët e tjera të Botës njihen si një sektor inovativ kyç në vend. Në to shikohet si një bërthamë prej së cilës duhet krijuar produkte të reja inovative dhe teknologji të bazuar nga rezultatet e aktivitetave kërkimore-shkencore që zhvillohen në universitet.

Për këtë qëllim janë sjellur një numër i madh të dokumenteve strategjike siç janë: Programi për nxitjen e investimeve, Programi për konkurrencë, Politika industriale dhe Strategjia për inovacione e cila është në përputhje me strategjinë e inovacionit të Bashkimit Europian, e njojur si Horizont 2020.

Si arritje më e madhe e Republikës së Maqedonisë në këtë plan dua të veçojë miratimin e Ligjit për veprimtarinë e inovacionit, miratuar në maj të këtij viti. Ky ligj parashikon krijimin e Fondit të Inovacionit me të cilën shteti në fillim të vitit 2014 mund të sigurojë ndihmë financiare për rangimin e rezultateve nga hulumtimet e aplikuara të universitetave dhe institucionet kërkimore shkencore në tregjet e brendshme dhe të jashtme.

Enti në mënyrë aktive merr pjesë në punën e të gjitha këtyre aktivitetave të qeverisë strategjike që unë mendoj se janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe do të ndihmojë krijuesit dhe pronarët e zgjidhjeve inventive për të realizuar idetë e tyre të reja në produkte konkrete, teknologjive dhe shërbimeve, duke kontribuar për të hapur tregje të reja dhe vende pune. Një nga priorititetet e Horizontit 2020 të BE-së është edhe zvogëlimi i papunësisë dhe rritja e aftësisë konkurruese të ekonomisë evropiane dhe kapacitetin e saj për të udhëhequr me rritjen e ekonomive botërore. Unë pres që Strategjia e re për pronësi industriale do të ofrojë aktivitete Entit në drejtim për të mbështetur kapacitetet të reja të universitetave në shtet.

Të nderuar përfaqësues të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Zyrës Evropiane të Patentave, duke shpresuar shoh edhe në mbështetjen tuaj të Entit për realizimin e këtyre prioritetave të qeverisë.

Asgjë më pak rëndësi nuk i japim bashkëpunimit bilateral me ju, të nderuar përfaqësues të Enteve fqinje. Megjithatë unë mendoj se bashkëpunimi rajonal por nëse doni edhe ai nën-rajonal është një faktor kyç për udhëheqjen e suksesshme me këto sfida.

Kjo Konferencë le të jetë fillimi i bashkëpunimit të përbashkët i rajonit tonë në këtë fushë.

Më lejoni ta përmbylli fjalin tim duke ju uruar një qëndrim të këndshëm në vend dhe një konferencë të sukseshme me shpresë se aktivitetet në fushën e promovimit të potentialit inovativ të universiteteve dhe menaxhimin e tyre do të intensifikohet dhe nën udhëheqjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Zyrës Evropiane të Patentave, Entit dhe zyrave kombëtare nga rajoni do të punojnë së bashku drejt arritjes së objektivave të Horizontit 2020.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj !